



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1153 Prot.

Roskovec, më 27.02 2020

VENDIM

NR. 14 .DATË 26.02 .2020

**“PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC NR.08,DATË 24.01.2020 “PËR NJË SHITESË NË LISTËN E INVENTARIT, MIRATUAR ME VKM NR. 1210, DATË 11.12.2009 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN KUMAN , TË QARKUT TË FIERIT ”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, gërma k) ; Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” , neni 16 ,pika 2, gërma b) paragrafi i) ; Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar) neni 6,pika 2, gërma b); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Ligji Nr.111/2018 “Për Kadastrën”, neni 2, gërma c, neni 69, pika 5, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Vkm nr. 1210, datë 11.12.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Kuman , të Qarkut të Fierit” Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Të shtohet në listën e Inventarit të Pronave, prona me numër rendor 478 , me nr. Pasurie 41/1 dhe indeks harte 215-A, Zyrat e Njësisë Administrative Kuman, me sipërfaqe 428m<sup>2</sup> truall + 230 m<sup>2</sup> ndërtesë me objekt 2 katësh nga ku kati përdhe është 230m<sup>2</sup> dhe kati i parë 206 m<sup>2</sup>
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

